

AKTI THEMELUES I SHOQERISE “ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS” –shpk



Ne Tirane, sot me date 23.02.2006, ne ortaket:

1. Olset Haxhiu, i datelindjes 16.09.1974, banues ne Lagjja Popullore Shijak me Nr. Regjistri Themeltar 22-4, me kombesi shqiptare dhe nen-shtetesi shqiptare dhe italiane.

2. Blenard Durmishi, i datelindjes 04.04.1979, me banim ne Rr. Pandi Dardha, Tirane me nr. Pasaporte Z1347454 me kombesi dhe shtetesi shqiptare.

V e n d o s e m:

Neni 1

Te themelojme shoqerine me pergjegjesi te kufizuar “ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS”-shpk qe ne vazhdim, ne kete akt themelimi, per shkurtim do te quhet Shoqeria.

Neni 2

Selia e Shoqerise eshte ne Tirane ne adresen : Rruga “Dull Keta” Pallati i ri, Sh.1, Ap.3. Shoqeria mund te hape filiale e zyra perfaqesimi ne qytete ose rrethina te tjera brenda dhe jashte territorit te shtetit shqiptar. Me vendim te asamblese, sipas kushteve te percaktuara ne statutin e saj, mund te krijoje edhe shoqeri te tjera te perbashketa brenda dhe jashte shtetit.

Neni 3

Shoqeria do te kete per objekt te veprimtarise se saj: studime, projektme, mbikqyrje, kolaudime dhe ndertime te te gjitha llojeve, prodhime materiale ndertimi, ngritje laboratoresh inxhinierike, si dhe tregtim mallrash me shumice e pakice, import-eksport.

Neni 4

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 100.000 (njqind mije) leke i ndare ne 100 kuota shoqerie me vlere 1000(njemije) leke secila nga te cilat: 50 (pesedhjete) kuota ne zoterim te ortakut Olset Haxhiu dhe 50(pesedhjete) kuota ne zoterim te ortakut Blenard Durmishi.

Neni 5

Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise eshte 50 vjet duke filluar ky afat nga momenti i regjistrimit te Shoqerise ne Regjistrin e Shoqerive Tregetare te Gjykates se rrethit Tirane kur ajo fiton personalitet juridik. Ky afat mund te zgjatet ose shkurtohet me vendim te asamblese se ortakeve sipas modaliteteve te percaktuara ne statut.

Neni 6

Administrator i Shoqerise eshte **Olset Haxhiu**, i datelindjes 16.09.1974, banues ne Lagjja Popullore Shijak me Nr. Regjistri Themeltar 22-4, me kombesi shqiptare dhe nen-shtetesi shqiptare dhe italiane.

Neni 7

Organizimi dhe funksionimi i Shoqerise realizohet sipas ligjeve ne fuqi te shtetit shqiptar qe rregullojne veprimtarine e shoqerive tregtare si dhe dispozitave te Statutit te Shoqerise i cili i bashkelidhet ketij akti duke qene pjese perberese e pandare e tij.

Neni 8

Ky akt themelues hartohet ne 5 kopje dhe nenshkruset prej themeluesve para noterit.

ORTAKET THEMELUES

Olset Haxhiu



Blenard Durmishi



**STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJESI TE KUFIZUAR
"ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS"-sh.p.k.**

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS"-shpk, themeluar në Tiranë më datë 23.02.2006 nga ortakët:

1. Olset Haxhiu, i datëlindjes 16.09.1974, banues në Lagjja Popullore Shijak me Nr. Regjistri Themeltar 22-4, me kombësi shqiptare dhe nën-shtetësi shqiptare dhe italiane.
 2. Blenard Durmishi, i datëlindjes 04.04.1979, me banim në Rr. Pandi Dardha, Tiranë me nr. Pasaporte Z1347454 me kombësi dhe shtetësi shqiptare.
- do të zhvillojë veprimtarinë e saj sipas dispozitave të këtij statuti:

**KREU I
DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

N e n i 1

Shoqëria emërtohet "ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS"-shpk dhe në vazhdim, në dispozitat e këtij statuti, për shkurtim, do të shkruhet Shoqëria.

N e n i 2

Shoqëria zhvillon veprimtarinë e saj në bazë të këtij statuti dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.

Shoqëria fiton personalitet juridik nga çasti i regjistrimit të saj në Regjistrin e Shoqërive Tregtare pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë.

N e n i 3

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë së saj :
Studime, projektme, mbikqyrje, kolaudime dhe ndërtime të të gjitha llojeve, prodhime materiale ndërtimi, ngritje laboratorësh inxhinierik, si dhe tregtim mallrash me shumicë e pakicë, import-eksport.

N e n i 4

Selia e Shoqërisë është në Tiranë në adresën: Rruga "Dull Keta" Pallati i ri, Sh.1, Ap.3.

N e n i 5

Shoqëria mund të hapë filiale dhe zyra përfaqësimi në qytete e rrethina të Republikës së Shqipërisë dhe jashtë territorit të saj.

N e n i 6

Kohëzgjatja e Shoqërisë është 50 vjet. Ky afat fillon nga çasti i regjistrimit të saj në Regjistrin e Shoqërive Tregtare pranë gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Afati i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet, të zgjatet ose shkurtohet, me vendim të asamblesë së ortakeve ose për shkaqe të tjera që legjitimojnë prishjen para kohe të saj.

KREU II KAPITALI THEMELTAR

N e n i 7

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) lekë, i ndarë në 100 kuota shoqërie me vlerë 1.000 (njëmijë) lekë secila nga të cilat: 50 (pesëdhjetë) kuota ne zotërim te ortakut Olset Haxhiu dhe 50(pesëdhjetë) kuota ne zotërim te ortakut Blenard Durmishi.

N e n i 8

Ortakët përballojnë humbjet e Shoqërisë deri në kufirin e vlerës së plotë të kapitalit themeltar dhe ndajnë fitimet në raport me pjesët në kapitalin themeltar.

N e n i 9

Kapitali fillestar i Shoqërisë mund të zmadhohet edhe me kontributet në natyrë. Kapitali themeltar i Shoqërisë nuk mund të ulet me poshtë se vlera e

kapitalit minimal të përcaktuar ne Ligjin 7638 dt 19.12.1992 për Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuar.

Transferimi i kuotave të pjesëmarrjes në kapitalin e Shoqërisë bëhet me akt-noterial duke ushtruar fillimisht të drejtën e parablerjes kundrejt ortakëve.

N e n i 10

Kapitali themeltar mund të zmadhohet ose zvogëlohet me vendim të asamblesë së ortakëve duke respektuar kërkesat e ligjit për shoqëritë tregtare.

N e n i 11

Asambleja përcakton fondin rezervë të Shoqërisë të domosdoshëm si dhe fonde të tjera të veçanta financimi për ushtrimin dhe zhvillimin e veprimtarisë së saj. Detyrimet eventuale të Shoqërisë mbulohen nga fondi rezervë, fonde të tjera ose me shuma suplementare të hollash të depozituara nga ortakët.

KREU III MAREDHENIET EKONOMIKE FINANCIARE

N e n i 12

Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti me perjashtim të vitit të parë të veprimtarisë së saj kur viti financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në organet tatimore dhe mbaron më 31 dhjetor 2006.

N e n i 13

Veprimtaria ekonomike e Shoqërisë pasqyrohet në bilancin e saj.

Bilanci i Shoqërisë (raporti i administrimit, inventari dhe llogaria vjetore) mbyllet brenda gjashtëmujorit të parë të vitit pasardhës dhe miratohet me vendim të asamblesë së ortakëve.

Ortakët ndajnë fitimet e Shoqërisë në raport me pjesët (kuotat) që zotërojnë në kapitalin themeltar pas shlyerjes së detyrimeve dhe krijimit të fondeve rezervë.

KREU IV
ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I SHOQËRISË

N e n i 14

Organet drejtuese të Shoqërisë do të jenë :

I.Asambleja e Ortakëve

II.Administratorët

Administrator i Shoqërisë është **Olset Haxhiu**, i datëlindjes 16.09.1974, banues në Lagjja Popullore Shijak me Nr. Regjistri Themeltar 22-4, me kombësi shqiptare dhe nën-shtetësi shqiptare dhe italiane.

N e n i 15

Ndryshimet në statusin e Shoqërisë mund të bëhen me vendimin e jo më pak se 4/5 e votave të asamblesë së ortakëve.

N e n i 16

Për kryerjen e veprimtarisë së saj Shoqëria ka të drejtë të punësojë specialistë ose punëtorë të thjeshtë, vendas dhe të huaj në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Marrëdhëniet e punës ndërmjet te punësuarve dhe Shoqërisë rregullohen sipas ligjeve në fuqi të shtetit shqiptar dhe marrëveshjeve kontraktuale midis tyre.

KREU V
MBYLLJA E VEPRIMTARISE SE SHOQËRISË

N e n i 17

Shoqëria pushon veprimtarinë e saj me mbarimin e afatit të caktuar në nenin 6 të këtij statuti duke iu nënshtruar procesit të likuidimit. Në këtë rast emërtimi i Shoqërisë pasohet nga shënimi "Shoqëri në likuidim e sipër".

Në çdo rast ortakët e Shoqërisë caktojnë një ose disa likuidatore të cilët hartojnë bilancin përfundimtar të veprimtarisë së Shoqërisë. Në pamundësi të ortakëve të Shoqërisë likuidatorët përcaktohen nga gjykata. Shoqëria mbetet person juridik deri në përfundim të procesit të likuidimit.

N e n i 18

Prishja e Shoqërisë është me pasoja ndaj të tretëve vetëm pas datës së publikimit të prishjes në Regjistrin e Shoqërive Tregtare.

Bilanci përfundimtar i likuidimit miratohet me vendim të asamblesë së ortakëve të cilëve u kalon gjithë pasuria e Shoqërisë pas shlyerjes së detyrimeve ndaj të tretëve nga ana e likuidatorëve. Në këtë vendim hiqet edhe mandati i likuiduesit.

**KREU VI
DISPOZITA TE FUNDIT**

N e n i 19

Shoqëria ka stemën e saj, vulën dhe llogari rrjedhëse në Bankë.

N e n i 20

Mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë krijimit, ekzistencës së Shoqërisë ose gjatë periudhës së likuidimit, ndërmjet ortakëve, ndërmjet saj dhe të tretëve, kur nuk zgjidhen me mirëkuptim, mund t'i paraqiten për zgjidhje gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

N e n i 21


Për probleme që nuk gjejnë zgjidhje në dispozitat e këtij statuti, zbatohen rregullat e përgjithshme e të veçanta që parashikojnë ligjet në fuqi të shtetit shqiptar, Kodi Civil, Kodi i Procedurës Civile, ligjet që rregullojnë veprimtarinë e shoqërive tregtare dhe ligjet e tjera që kanë lidhje me këtë veprimtari.

N e n i 22


Ky statut hartohet në pesë kopje dhe nënshkruhet nga ortakët.

ORTAKET THEMELUES

Olset Haxhiu



Blenard Durmishi



REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
NR 1492 REP 614

Tirane me 23.02.2006

V E R T E T I M

Sot me dt 15.02.2006 para meje noteres Manushaqe Sharka me seli ne rrugen "Gjergj Fishta" Tirane, u paraqiten kerkuesit Olset Haxhiu i paisur me document identifikimi certificate personale me foto 22-4 dhe Blenard Durmishi i paisur me pasaporten nr Z1347454 te cilet kerkuan vertetimin e nenshkrimit te hedhur ne dokumentacionin , akt themelim e statut te shoqerise "ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS'shpk. Madhor dhe me zotesi juridike te plote per te vepruar. Ata kerkuan vertetimin e nenshkrimit te hedhur ne kete akt themelim e statut te shoqerise . Konform nenit 55 te Ligjit Mbi Noterine,une noterja i vertetoj ato



N O T E R E

Manushaqe SHARKA